




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



KA/Nr. 2909/20
Datë: 23/11/2020

Komisioni i Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i themeluar me Vendimin Nr.1448/20D, ta datës 04.09.2020, në përbërje të Faton Merovci, Muhamet Qerimi dhe Krenare Sogojeva Dermaku, në shqyrtimin e lëndës administrative, respektivisht ankesës së Kolegjit ISPE, nr.ref.1060/20 D të datës 24.07.2020 dhe letra përcjellëse nr. Ref. 1496/20H datë 8.09.2020 kundër Vendimit të KSHC Nr. 576/20D të datës 22.06.2020 për refuzimin e kërkesës për akreditimin e programit Studime të Sigurisë, Bsc, 180 ECTS, e pranuar më 23.10.2020, në mbështetje të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e datës 5.11.2020, me shumicë votash, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Kolegjit ISPE nr. Ref.1060/20H e datës 24.07.2020 me letrën përcjellëse 1496/20H të datës 8.09.2020 dhe vërtetohet Vendimi i KSHC-së Nr. 576/20D i datës 22.06.2020.

ARSYETIM

Kolegji ISPE brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesën me numër protokolli nr. Ref.1060/20H e datës 24.07.2020 me letrën përcjellëse 1496/20H të datës 8.09.2020, pranë Komisionit të Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të Programit të studimit, Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS, kundër Vendimit Nr. Ref. 576/20D, datë 22.06.2020 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me të cilin Vendim është refuzuar kërkesa e Kolegji ISPE, Nr. Prot. 2129/19H, datë 31.10.2019, për akreditim të Programit të studimit, Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS.

Pala ka pretenduar se bërë shkelje ligjore nga KShC duke mos i paraqitur faktet ashtu siç janë paraqitur pranë organeve kompetente përgjegjëse për vlerësimin dhe aprovimin e kërkesës së Kolegji ISPE Nr. Prot. 2129/19H, datë 31.10.2019.

KSHC nëpërmjet vendimit me Nr. Ref. 576/20D në pjesën e arsyetimit në pikën 1, paragrafi 1, konstaton se Kolegji ISPE për programin Studime të Sigurisë BA, 180 ECTS, ka paraparë këta

persona si bartës të këtij programi: Bajram Ibraj, Avni Mazrreku, Oreta Saliaj, Rifat Demaliaj dhe Aleksandër Muskaj.

Ndërsa, në po të njëjtin Vendim, paragrafi 3 i pikës 1, thuhet se “...ky program ka 180 ECTS, dhe sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji ISPE, duhet të ketë të paktën tre (3) staf akademik me gradën shkencore PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit...”. Tutje në paragrafin pasues thuhet se “...pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji ISPE për këtë program të studimit, u konstatua që tre nga pesë bartësit e programit të prezantuar në këtë program të studimit, nuk i plotësojnë kushtet sipas Udhëzimit Administrativ...”. Derisa në paragrafin pasues të vendimit në fjalë konstatohet se *prof. Bajram Ibraj ishte deklaruar si staf i rregullt me orar të plotë në dy institucione të arsimit të lartë, Oreta Saliaj i kishte munguar leje qëndrimi në Kosovë dhe Aleksandër Muskaj i kishte munguar deklarata nën betim.*

Provat e administruara:

- Ankesën me numër protokolli 1060/20D, të datës 24.07.2020, së bashku me Anekset e bashkangjitura në Ankesë, të parashtruar nga Kolegji ISPE;
- Ankesën me numër protokolli 1496/20H, të datës 08.09.2020, së bashku me Anekset e bashkangjitura në Ankesë, të parashtruar nga Kolegji ISPE;
- Kërkesë për dokumentacioni shtesë për programin në proces të vlerësimit-BA Studime të Sigurisë me nr. Prot. 370/20H të datës 16.03.2020
- E-maili i Leonis Gashi për AKA-në përfshirë z. Naim Gashi dhe z. Arianit Krasniqin i datës 13.04.2020;
- Vendimin e KSHC-së, Nr. Ref. 576/20D, i datës 22.06.2020.
- Raporti përmbledhës të KSHC-së për rishqyrtimin e ankesës nga takimi i datës 02.09.2020;

Shpjegim i situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi

Komisioni i Ankesave pranë AKA-së, ka pranuar ankesën nr. Ref.1060/20H, datë 24.07.2020 me letrën përcjellëse nr. 1496/20H të datës 08.09.2020, të Kolegjit ISPE më datë 23.10.2020, së bashku me dokumentacionin dhe raportin e KSHC-së nga takimi i datës 02.09.2020, me të cilën ka përshkruar pretendimin e palës dhe arsyen e refuzimit të kërkesës për akreditim.

Komisioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkëngjitura ka gjetur se:

Kolegji ISPE ka paraqitur si bartës të programit Studimet e Sigurisë BA, 180 ECTS, pesë (5) persona (Bajram Ibraj, Avni Mazrreku, Oreta Saliaj, Rifat Demaliaj dhe Aleksandër Muskaj).

Kolegji ISPE ka realizuar takim me KSHC-në më datë 07.02.2020, ku palës i është dhënë mundësia që të plotësojë dokumentacion për stafin të cilin e ka paraqitur si bartës të programeve me orar të plotë.

Kolegji ISPE në shkresën nr.ref, 370/20H, të datës 16.03.2020 ka ofruar dokumentacionin shtesë.

KSHC më datë 01.04. 2020 ka shqyrtuar dosjet e bartësve të programit dhe ka konstatuar se prof. Bajram Ibraj ishte deklaruar si staf i rregullt me orar të plotë në dy institucione të arsimit të lartë, prof. Aleksandër Muskaj i kishte munguar deklarata nën betim që dëshmon se i njëjti është staf i rregullt në Kolegjin ISPE dhe prof. Oreta Saliaj i kishte munguar leje qëndrimi në Kosovës, si shtetase e huaj.

Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave

Komisioni i Ankesave, pasi ka konstatuar se ankesa e Kolegjit ISPE është parashtruar brenda afatit kohor, ka shqyrtuar pretendimet e palës për refuzimin e kërkesës të Kolegjit ISPE, Nr. Prot. 2129/19H, datë 31.10.2019, për akreditim të Programit të studimit, Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS.

Komisioni i Ankesave pasi ka analizuar ankesën dhe gjithë dokumentacionin, përfshirë edhe dosjen e bartësve të programit, ka gjetur se:

Kolegji ISPE ka paraqitur si bartës të programit Studimet e Sigurisë BA, 180 ECTS, gjashtë (6) persona, respektivisht Bajram Ibraj, Avni Mazrreku, Oreta Saliaj, Rifat Demaliaj dhe Aleksandër Muskaj

Nga shqyrtimi i dosjeve ka rezultuar se:

- Bajram Ibraj ishte deklaruar si staf i rregullt me orar të plotë në dy institucione të arsimit të lartë, e për çka, sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, respektivisht nenit 30, paragrafin 2, i njëjti është larguar nga lista e bartësve të programit. Kjo dëshmohet edhe përmes platformës së e-akreditimit.

- Oreta Saliaj i kishte munguar leje qëndrimi në Kosovë, si shtetase e huaj, e për të cilën Kolegji ISPE nuk kishte dorëzuar dokumentet plotësuese që dëshmojnë të kundërtën.

- Aleksandër Muskaj i kishte munguar deklarata nën betim për vitin akademik 2019/2020. Më konkretisht, prof Aleksandër Muskaj, deri me datën 31 tetor 2019, ka vendosur deklaratën nën betim, po e cila ka qenë e nënshkruar me datë 16.04.2018.

Tutje, Kolegji ISPE me datën 16.03.2020 i është drejtuar AKA-së me Shkresën nr. Ref. 370/20H, ku ndër të tjerash shënon:

“Ju lutem bashkangjitur kësaj kërkesë shihni dokumentacionin respektiv për stafin e deklaruar nga ana e kolegjit ISPE për programin BA Studime të Sigurisë:

3. Aleksandër Muskaj, shihe te bashkangjitur aplikimin për zgjatjen e Leje qëndrimit por për shkak të situatës së fundit të krijuar si pasojë e përhapjes së virusit infektiv Covid 19 pavarësisht konfirmimit nga ana e MPB-se se Leje qëndrimi është gati në pamundësi tërheqjes fizike si pasojë e kufizimit të lëvizjes për disa zona momentalisht nuk është tërhequr. Ne rastin e parë që krijohen mundësitë do të tërhiqet vendimi dhe do ta sjellim në AKA.”

Kjo shkresë ka qenë rezultati nga takimi i Kolegjit ISPE me KSHC që është mbajtur me datën 07.02.2020, ku palës i është dhënë mundësia nga KSHC që të plotëson dokumentacion për stafin, përfshirë edhe deklaratën në betim të nënshkruar nga prof. Aleksandër Muskaj.

Pala në shkresën nr.ref, 370/20H, të datës 16.03.2020 nuk e ka dërguar Deklaratën nën betim të profesorit Aleksandër Muskaj, por vetëm aplikimin për zgjatjen e Leje qëndrimit dhe arsyetimin lidhur me këtë aplikim .

KSHC ka mbajtur takimin me datë 1 Prill 2020, ku ka shqyrtuar dosjen e Kolegjit ISPE e të cilës i ka munguar Deklarata nën betim e prof. Aleksandër Muskaj, andaj ka vendosur se i njëjti nuk llogaritet staf i rregullt për të qenë bartës i programit. Rrjedhimisht, Kolegji ISPE ka mbetur me vetëm dy bartës që plotësojnë kriteret sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë.

Pala Deklaratën nën betim për prof. Aleksander Muskaj e ka dërguar me datë 13.04.2020, përmes shkresës (email) nga Leonis Gashi drejtuar AKA-së, respektivisht 13 ditë pas mbajtjes së takimit të KSHC-së, ku është vendosur për mos akreditimin e programit Studimet e Sigurisë, BA, 180 ECTS.

Baza ligjore e vendimit dhe arsyeja pse është e zbatueshme në rastin konkret

Bazuar në nenin 26, paragrafi 5.3.4 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, i cili përcakton se: *” Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për një grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për cdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit.”*

Marrë parasysh nenin 30, paragrafin 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, i cili përcakton se: “Stafi akademik i cili ndryshon angazhimin brenda një viti akademik nuk do të pranohet nga AKA për qëllime të vlerësimit dhe akreditimit.”

Komisioni i Ankesave ka vërtetuar se nuk janë përmbushur kërkesat ligjore sipas nenit 26, paragrafin 5.3.4. të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe vlerëson se mbi këtë bazë ligjore ka arsyeshmëri të plotë Vendimi Nr. 576/20D i datës 22.06.2020 i KSHC-së.

Pala me datë 29.10.2020 dhe 2.11.2020, ka qenë e ftuar nga Komisioni i Ankesave për ta ushtruar të drejtën e vet për tu dëgjuar, ashtu siç e parasheh nenin 95 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kolegji ISPE e ka realizuar këtë të drejtë dhe ka mbrojtur të njëjtat pretendime si në ankesë.


Në përfundim,

Komisioni i Ankesave pasi shqyrtimit dhe administrimit të provave, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi, mbi bazën e kompetencave të dhëna me nenin 22, paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Komisioni i Ankesave në AKA

KA/Nr. 2909/20, datë 23/11/2020

Procesmbajtësi


Arianit Krasniqi

Kryetari i Komisionit të Ankesave


Faton Merovci



Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve në gjykatën kompetente për konfliktet administrative.